



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 192, Datë 28/12/2016

Bazuar në informacionin e marrë e marrë nga televizionin “Agon Channel” në emisionin “ÇA THU” të transmetuar në datë 06.07.2015, në lidhje me keqtrajtimin e fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32/1/c të ligjit Nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: “*Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji*”, nenit 46 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “*Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara*” me Urdhrin Nr. 114, datë 08.07.2015, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes në lidhje me veprimet e dhunshme dhe mospërfillëse të punonjësve të Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

KONSTATOI:

Në pamjet filmike audiovizive të transmetuara në emisionin “CA THU” në datë 06.07.2015, dalloheshin qartë veprimet e dhunshme dhe sjelljet mospërfillëse të punonjësve të shtëpisë së fëmijës ndaj disa fëmijëve të këtij institucioni.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Diskriminimi për shkak të moshës është shkak i cili gëzon mbrojtje nga ligji dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 664, datë 07.07.2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi autorizoi një punonjës të zyrës së Komisionerit, të informohet në lidhje me situatën e raportuar në televizionin "Agon Channel" në emisionin "ÇA THU", të datës 06.07.2015 për dhunën e ushtruar ndaj fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër.

Znj. [Emri i punonjës] me detyrë Drejtore e Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër në takimin e zhvilluar në datë 07.07.2015, konfirmoi faktin e ndodhur të ushtrimit të dhunës me datë 20.06.2015 jo në mjediset e shtëpisë së fëmijës, Shkodër por në një vend ku po prisnin makinën për ti transportuar drejt Shtëpisë së Fëmijës, sepse fëmijët sipas drejtoreshës kanë qenë në një ditëlindje. Gjatë këtij takimi drejtoresha ka shprehur në çdo moment indinjatën e saj dhe ka konfirmuar faktin se znj. [Emri i punonjës] ka qenë një punonjëse e rregullt dhe korrekte. Fëmijët sipas drejtoreshës në asnjë moment nuk kanë shfaqur frikë apo të kenë pohuar se mbi to është ushtruar dhunë. Në këtë takim znj. [Emri i punonjës] shprehu shqetësimin për mungesën e psikologut në institucion.

Znj. [Emri i punonjës] konfirmoi se ndaj tri punonjësve të përfshirë në video, janë marrë këto masa:

- Punonjësja, znj. Manjola Bani [Emri i punonjës], ka punuar pranë këtij institucioni që nga vitit 2002. Gjatë kësaj periudhe ndaj kësaj punonjëseje nuk ka patur ndonjë vërejtje ose ankesë për punën apo sjelljet e saj. Në vitin 2013 kjo punonjëse është ulur në detyrë për shkak se gjatë periudhës së pushimeve të verës në Velipojë ka qenë e sëmurë dhe kishte nevojë për tu pajisur me raport mjekësor dhe për ketë arsye drejtoresha e asaj kohe e ka parë të arsyeshme uljen në detyrë. Punonjësja po ndiqet penalisht për neglizhencën e treguar në video.
- Punonjësja, znj. [Emri i punonjës] ka punuar pranë institucionit që nga viti 1995. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndonjë vërejtje apo ankesë për ketë edukatore. Në vitin 2013 kjo punonjëse është larguar nga puna për shkak se ka marrë leje pa të drejtë page për arsye shëndetësore. Punonjësja po ndiqet penalisht për veprimet e treguara në video.
- Punonjësi, z. [Emri i punonjës] është i punësuar që nga viti 2014 nga Projekti IADSA. Gjithashtu dhe ky punonjës po ndiqet penalisht.

¹ Punonjësja që shfaqet në video duke ushtruar dhunë ndaj fëmijëve



Me datë 21.07.2015, në zbatim të Urdhrit të Inspektimit Nr. 119, datë 15.07.2015 u realizua inspektimi pranë Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër. Në ana e Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër ishin të pranishëm znj. [Emri i personit], me detyrë, Drejtore e DRSHSSH, Shkodër, znj. [Emri i personit], me detyrë Drejtore e Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër dhe znj. [Emri i personit], me detyrë, Përgjegjëse e Sektorit Social.

Gjatë inspektimit znj. [Emri i personit], informoi se vitin e kaluar në datë 07.02.2014 ka patur një rast të cenimit të të drejtave të fëmijëve nga ana e punonjësës (E.LI) për të cilën është marrë masa e lirit nga detyra nga ana e Drejtorit të SHSSH², si dhe i gjithë dokumentacioni mbi kriteret e punësimit, përshkrimin e punës dhe të trajnimit të punonjësve gjenden pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH. Gjithashtu znj. [Emri i personit] informoi se ka kërkuar nga SHSSH shtimin në organikën e institucionit të një punonjësi në pozicionin e psikologut.

Me shkresën nr. 699, datë 24.07.2015 i është kërkuar informacion SHSSH mbi të dhënat e punonjësve të Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër.

Me shkresën nr. 1650/1, datë 06.08.2015, SHSSH ka dërguar pranë Komisionerit dokumentet në lidhje me të dhënat e punonjësve, kriteret e punësimit dhe trajnimet e tyre, gjithashtu ka dërguar dhe temat e trajnimeve të punonjësve të institucioneve rezidenciale për fëmijë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Bazuar në faktet e mësipërme dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerëson:

Legjislacioni shqiptar përmban bazat ligjore për mbrojtje të veçantë për fëmijët dhe të rinjtë. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 54 të saj parashikon se: 1. "Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti", 2. "Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë", 3. "Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal", ndërsa në nenin 59/1/e përkujdesja ndaj fëmijëve jetimë është sanksionuar si objektiv social, në të cilin parashikohet se: 59/1- "Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët".

Bazuar mbi pamjet filmike dhe informacionit të dhënë nga drejtuesja e institucionin por dhe veprimet e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse si Ministria e Mirëqenies Sociale e Rinisë si dhe nga Shërbimi Social Shtetëror, Komisioneri vlerëson se dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuar

² Shërbimi Social Shtetëror.



dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Bazuar nenin 3, pika 2 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “Diskriminim i drejtpërdrejtë është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”, konstatohet se veprimet e kryera nga punonjësit znj. *Manjola Banishta*, znj. *Albert Reka* dhe z. *Edvana Sulaj* ndaj fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër, përbëjnë objekt të diskriminimit të drejtpërdrejtë për shkak të moshës.

Referuar deklaratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të datës 07.07.2015 njoftohet se është kryer ndalimi me iniciativë për shtetasen Edvana Sulaj, si dhe ka filluar procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasit: Manjola Banishta dhe Albert Reka. Materialet i kanë kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për veprat penale “Keqtrajtimi i të miturit”, “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga Kodi Penal.

Institucioni, Shtëpia e Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër funksionon në bazë të standardeve dhe procedurave të bazuara sipas politikave të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe është në varësi të Shërbimit Social Shtetëror.

Referuar Urdhrit të Kryeministrit Nr.88, datë 25.10.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror” organika e Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër përbëhet nga 18 punonjës. Referuar informacionit të dërguar nga SHSSH, Tabela nr.1, informohet se: Punonjësja (që ka ushtruar dhunën ndaj fëmijës) znj. Edvana Sulaj kryente detyrën si kujdestare e punësuar prej vitit 2007, ka kryer shkollën e mesme pedagogjike dhe ka zhvilluar disa trajnime nga viti 2010 e në vazhdim. Punonjësja znj. Manjola Banishta kryente detyrën si specialiste edukimi prej vitit 2005, është diplomuar në Shkenca Edukimi për ciklin parashkollor dhe ka kryer disa trajnime nga viti 2010 e në vazhdim. Referuar sa më sipër verifikohet se këto punonjëse kanë arsimin përkatës sipas pozicionit dhe kanë një eksperiencë të gjatë pune pranë institucionit.

Në standardin X të përcaktuar sipas VKM nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale” shkruhet se: “Ka procedura që nxisin sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve dhe që sigurojnë mbrojtjen e tyre nga abuzimet. Procedurat njihen dhe kuptohen nga i gjithë stafi (përfshirë stafin e ri, të vjetër, vullnetar si edhe stafin e përkohshëm”. Në zbatim të këtij standardi SHSSH, vetëm pas ngjarjes së dhunës së ushtruar ndaj fëmijës nga punonjësja e shtëpisë së fëmijës Shkodër ka hartuar dhe shpërndarë Urdhrin nr. 1574, datë 16.07.2015 “Për zbatimin e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror”, Deklaratën e njohjes dhe zbatimit të Kodit të Sjelljes për



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

punonjësit, si dhe në bashkëpunim me ISHPSHSH³ ka kryer monitorim në të gjithë IPSH⁴ të fëmijëve lidhur me procedurat e mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi⁵ në zbatim të urdhrat të ministrit 177, datë 13.07.2015 “Për monitorimin dhe vlerësimin e institucioneve të përkujdesit për fëmijë”.

Referuar sa më lart, Komisioneri vlerëson se nga ana e Shërbimit Social Shtetëror duhet të ishin marrë masa më përpara për monitorimin e situatës së mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi dhe dhuna në institucionet e përkujdesit për fëmijë si dhe duhet të ishin njohur dhe trajnuar punonjësit e këtyre institucioneve me politikat e mbrojtjes së fëmijëve dhe të zbatimit të kodit të sjelljes.

Në mënyrë që institucionet e përkujdesit publik për fëmijë të plotësojnë standardin e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale, Komisioneri rekomandon që në vazhdimësi të merren masa për rritjen e kapaciteteve të stafit të punonjësve, të ngrihet një sistem monitorimi që fëmijët të shprehen për përdorimin e dhunës dhe pastaj të verifikohen pretendimet.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se duhet të shikohet mundësia për parashikimin në organikën e institucionit të një punonjësi në profesionin si psikolog, për të qenë në kontakt të përditshëm me fëmijët, për të marrë dhe raportuar rastet e mundshme të abuzimit me fëmijët si dhe për të kryer një vlerësim periodik të gjendjes së fëmijëve.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, në lidhje me ushtrimin e dhunës ndaj fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër, në veprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës nga punonjësit znj. Edyza Kula, znj. Manjola Banishte dhe z. Albert Reka.
2. Komisioneri rekomandon, Shërbimi Social Shtetëror të marrë masa për:
 - Kualifikimin dhe vlerësimin psikologjik të vazhdueshëm për stafin e specialistëve të edukimit dhe kujdestarëve të Shtëpisë së Fëmijëve Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër.
 - Ngritjen e një sistemi monitorimi që fëmijët të shprehen për abuzimet që mund të ndodhin në mjediset e institucionit.
 - Shtimin në organikën e institucionit të një psikologu për të qenë në kontakt të përditshëm me fëmijët.

³ Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

⁴ Institucionet e Përkujdesit Shoqëror

⁵ Faqe 10, raporti 2015 I SHSSH.



3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Shërbimi Social Shtetëror, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al